

Prof. Asoc/Markela Muça

Prof. Asoc/Markela Muça është e punësuar me kohë të plotë pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.

Ka një përvojë pune 20 vjeçare si pedagog/e dhe studiues/e. Pas diplomimit në Universitetin Aristotelio (Selanik, Greqi), në vitin 2001, studimet pasuniversitare dhe ato doktorale lidhen me Probabilitetin, Statistikën dhe Metoda të Analizës Numerike. Titullare e grupit mësuesor kërkimor *“Probabilitet dhe Statistikë”*. Udhëheqëse shkencore dhe opONENTE në disertacione doktorale.

Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë analizimin e modeleve statistikore dhe aplikimin e tyre duke përdorur kryesisht SPSS, MATLAB dhe R. Kontributi im në kërkime përqendrohet në paraqitjen, interpretimin dhe analizimin e rezultateve me teknika të ndryshme parashikimi dhe klasifikimi (si Analiza e Mbijetesës, Analiza e Grupeve, K-means, etj.). Studimet e mia përqendrohen në metodat e avancuara të parashikimit si vlerësimet Kernel dhe Bayesian, të cilat përdoren për të vlerësuar shpërndarjen e të dhënave dhe parametrat e modeleve. Kjo përmban krahasime dhe konsiderata gjithëpërfshirëse, si në aspektin teorik ashtu edhe praktik, kur aplikohet në grupe të dhënash reale. Përdorimi i softuerëve përfshin opsionet ekzistuese dhe krijimin e skripteve specifike në R dhe MATLAB për të siguruar një analizë të plotë dhe të personalizuar.

Ka marrë pjesë në disa projekte kombëtare dhe ndërkombëtare si SPNA 2014/2015, Integrimin e Inteligjences Artificiale në avancimin e kërkimit ndërdisiplinor në Universitetin e Tiranës, Energy Transition in European Countries në bashkëpunim me Universitetin Bicocca, Milano, Itali, Sjellja politike dhe personaliteti, projekti dypalësh Shqipëri-Kosovë, Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional Të Mësuesve etj.

Ka shërbyer në pozicione drejtuese e disa projekteve dhe workshopeve të zhvilluara në departament:

Anëtare e Grupit Editorial, në Revista Shkencore Evropiane, Anëtare e grupit të recensuesve nga revista të ndryshme shkencore, Anëtare e Komitetit Shkencor në Konferenca Kombëtare dhe Ndërkombëtare dhe Koordinatorë Lokale dhe Anëtare e Komitetit Shkencor në Workshope.

Përfaqësuese nga UT në cilësinë e anëtarit të Komisionit ad-hoc për përzhedhjen anatarëve të Këshillit të Statistikave.

Anëtare në grupin e vlerësimit të pikëve të maturantëve në Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

Ka botuar dhe është bashkëautore e disa librave universitar.

Udhëheqëse shkencore në dy doktorata me temë:

“Analiza e parashikimeve dhe klasifikime në machine learning duke përdorur teorinë bayesiane: modelet shumëpërmasore të miksuara beta dhe të tjera në njohjen e Mikro- shprehjeve”

“Modelet e klasifikimit të tekstit. Aplikime”

Aktualisht, ajo vazhdon të japë një kontribut të vyer në zhvillimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në fushën e statistikës, duke mbështetur avancimin e metodologjive dhe aplikimeve të saj.